

---

## AKT THEMELIMI “DURANA” SHPK

### **1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë**

Emri i shoqërisë do të jetë “**DURANA**” SHPK, nga këtu e më poshtë referuar edhe si “shoqëria”, e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar” ose “SHPK”.

### **2. Ortaku i shoqërisë**

Ortak të shoqërisë janë: **Z. Marin Pahija**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 14.01.1989, banues në Tiranë, i identifikuar nga karta e identitetit me nr. Personal I90114045U, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe **Z. Faolt Pahija** i datëlindjes 23.05.1985, banues në Tiranë, i identifikuar nga karta e identitetit me nr. Personal I50523065S.

### **3. Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria organizohet dhe funksionon si një shoqëri e tipit HOLDING, me pjesëmarrje direkte ose indirekte në kapitalin aksionar te shoqërive të tjera tregtare, vendase ose të huaja. Per rrjedhoje, shoqëria mund të koordinojë, organizojë, kontrollojë dhe menaxhojë në cilësinë e shoqërisë HOLDING, në aspekting ligjor, teknik, administrativ, financiar, te marketingut dhe strukturor të gjitha shoqëritë e grupit dhe/ose shoqëri të tjera, duke krijuar për këtë qëllim borde të centralizuara menaxhimi dhe administrimi si dhe duke ofruar shërbime të këshillimit financiar, teknik, zhvillimit strategjik, zhvillimit të biznesit etj.

**Gjithsesi operimi si një shoqeri e tipit Holding, nuk e ndalon shoqerine nga kryerja e objektit te veprimtarive te lejuara nga legjislacioni shqiptar ne fushen e projektimit, ndertimit, supervizimit, apo import-eksport te lidhur me permbushjen e aktivitetit te saj tregtar.**

Me specifisht, objekti i veprimtarisë do të jetë:

- **Investimi ne instrumenta financiar (te cilet perfshijne pa kufizime titujt e pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerive tregtare (aksione ose kuota), titujt e borxhit publik apo privat, aksione ose kuotat ne fonde investimesh etj);**
- **investime ne pasuri te paluajtshme dhe ne asete te tjera te prekshme apo te paprekshme;**



- 
- ofrimi i sherbimeve te konsulences per shoqerite e kontrolluara prej saj dhe/ose te trete (te cilet perfshijne pa kufizime konsulencen e natyres financiare, manaxheriale, ligjore, IT, arkitekturiale, zhvillim softwares, marketingut etj.) ne perputhje me legjislacionin e zbatueshem ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj;
  - Shoqeria mund te kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

#### 4. **Selia e shoqërisë**

- Rruga "Prush", Zona Kadastrale 3064, Pasuria Nr.151/57, Njesia Administrative Vaqarr, Tirane.
- Shoqeria mund te hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund te marrë pjesë në shoqeri te tjera shqiptare dhe/ose te huaja, që ekzistojnë ose do te krijohen në te ardhmen. Këto mund te krijohen ose mbyllen me një vendim te thjeshtë te administratorit.

#### 5. **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit te saj në Regjistrin Tregtar te Qendrës Kombëtare te Regjistrimit.

#### 6. **Kapitali themeltar**

- Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 5,000,000.
- Kapitali përbëhet nga 2 (dy) kuota me vlerë nominale: ALL 2,500,000, që zotërohet nga Z. Marin Pahija dhe ALL 2,500,000 që zotërohet nga Z. Faolt Pahija.

#### 7. **Organet vendimmarrëse te shoqërisë**

Organet vendimmarrëse te shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.



---

#### **8. Administratori**

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- Administrator i parë i shoqërisë është: **Z. Marin Pahija** shtetas Shqiptar, e datëlindjes 14.01.1989, e identifikuar nga karta e identitetit me nr. personal I90114045U.

#### **9. Likuidimi i shoqërisë**

Në rast prishje të shoqërisë, likuidimi apo falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

**Datë 07.09.2023**

### **ORTAKËT E SHOQËRISË**

**MARIN PAHIJA**

**FAOLT PAHIJA**

Faolt Pahija